



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:013341

Datë: 25.01.2022

Numri i dokumentit: 02643476

C.nr.101/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-gjyqtari Misin Frangu, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësit Rr.S. me vendbanim në fshatin ... rr.' ...", në Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson Mentor Avdiu jurist i diplomuar Zyrtar Ligjor në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për Regjionin e Ferizajt me adres rr.'Reçakut", objekti i QMF-1 kati II. nr.14, Ferizaj, kundër të paditurës Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, në çështjen juridike pagesën e pagave jubilarë, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor më 24.01. 2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET si e themeltë kërkesëpadia e paditëses Rr.S. me vendbanim në fshatin ... rr. "...", në Ferizaj, ashtu që **DETYROHET** e paditura Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, që paditësit në emër të dy pagave jubilarë t'ia paguaj shumën prej 1,209.24 € (Një mijë e dyqind e nënë euro e njëzet e katër cent), me kamatë ligjore prej 8% nga dita e marrjes këtij aktgjykimi deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e për taksën gjyqësore në shumën prej 30.00 €, të gjitha brenda afatit prej 7 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m i

Paditësja Rrahim Salihu me vendbanim në fshatin ... rr.' ...", në Ferizaj të cilin me autorizim e përfaqëson Mentor Avdiu jurist i diplomuar Zyrtar Ligjor në Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës për Regjionin e Ferizajt me adresë rr.'Reçakut", objekti i QMF-1 kati II. nr.14, Ferizaj, më datë 26.01.2021, në këtë gjykatë ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Spitali i Përgjithshëm Ferizaj, në emër të një page jubilarë të ja kompensoj shumë prej 1,209.24 € (Një mijë e dyqind e nënë euro e njëzet e katër cent), duke konsideruar se tek e paditura është në marrëdhënie pune si Vozitës në Spitalin Përgjithshëm Ferizaj mbi 21 vite përvojë pune.

E paditura, më 26.02.2021, ka paraqitur përgjigje në padi, duke e kundërshtuar në tërësi të gjitha pretendimet e palës paditëse në padi, ku thekson se kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar përkundër marrëveshjes kolektive, SHSKUK-ja, nuk ka fonde të veçanta për pagesat jubilarë çka që Spitali i Përgjithshëm i Ferizajt nuk ka mjete për pagesat jubilarë sipas nenit 52 të MPK-së, dhe si e tillë është e pa realizuar nga ana e Spitalit të Përgjithshëm të Ferizajt.

Gjykata pa caktuar seancë gjyqësore, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të tjera të lëndës, përgjigjen në padi të paraqitur nga ana e të paditurës në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie të punës si infermier dhe atë mbi 21 vite.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratën Kolektive Sektoriale të nënshkruar nga Qeveria e Kosovës, për punëmarrësin dhe Federatën e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës siç parashihet me nenin 90 par.4 të Ligjit të Punës e cila është nënshkruar nga të dy palët dhe në nenin 17 par.3 pika 3.1. 3.2 dhe 3.3 të Kontratës Kolektive Sektoriale është paraparë që punëtori ka të drejtë në shpërblim jubilar për 10 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë të një pagë mujore, për 20 vjet të përvojës në punë te punëdhënësi i fundit në vlerë prej dy paga mujore, për 30 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë prej tri pagave mujore, punëdhënësi i fundit është ai që i paguan

shpërblimet jubilarë, shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, çka do të thotë se e paditura është dashur që me rastin e arritjes së përvojës së punës të punëmarrësit-paditësit prej 21 vjet t'ia paguaj një pagë neto prej 604.62 €, nga dita e arritjes së këtij kushti të cilin paditësi e ka plotësuar, siç shihet nga lista e pagës ku paditësi ka përvojë të punës 21 vite. Edhe sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë së aprovuar, po ashtu kjo vërtetohet me listën e pagave, e bashkangjitur si provë, e që rezulton se paditësja gëzon pagë neto 604.62 €.

Sa i përket kundërshtimit të paditurës se kërkesëpadia e paditësës duhet të refuzohet për faktin se e paditura nuk ka pasur fonde të veçanta që ti përmbushë këto detyrime, këto pretendime për gjykatën janë të pa bazuara për faktin se me nenin 4 të kësaj kontrate e paditura është e obliguar që ta zbatojë këtë kontratë kolektive sektoriale dhe me kohë të planifikojë buxhetin për këto raste.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *‘Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë’*.

Referuar dispozitës të cituar si më lartë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, sepse kërkesëpadia e paditësit ishte qartazi e themeltë dhe se kundërshtimi i të paditurës, konsiderohet sipërfaqësor dhe gjuhësor kur thuhet se kundërshton kërkesëpadinë e paditësit dhe se kundërshtimi nuk ishte real dhe thelbësor. Çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës është natyrës teknike, andaj gjykata ishte e bindur në mënyrën e vendimmarrjes.

Për më tepër në supozimin se qëndron pretendimi i tillë, gjykata vlerëson se bëhet fjalë për diferencë të shumës financiare tejet të vogël, e që caktimi eventual i seancës gjyqësore për vërtetësinë e këtij pretendimi, vetëm sa do të krijonte shpenzime të procedurës, përtej shumës së pretenduar, dhe rrjedhimisht do të ishte në kundërshtim me parimet e procedurës civile, të normuara në dispozitën e nenit 10 par.1 të LPK-së, në të cilën dispozitë përcaktohet që çështja duhet trajtuar pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime.

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditësit t'ia paguaj shpenzimet në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 30.00 €.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

C.nr.101/21, me datë 24.01.2022

Gjyqtari

Misin Frangu

KESHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 7 (shtatë) dite, nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.